



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



## **EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së nëntë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 26.8.2013, e cila filloi në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Prof.dr. Isa Mustafa, kryetar i Komunës, dr. Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit, këshilltarët: Hazir Borovci, Shaip Hajrizi, Bekim Gashi, Ismail Kasumi, Musli Mehaj, Fetah Salihu, Hetem Kupina, Avdush Dobratiqi, Vjollca Dibra - Ibrahim, Rrahman Ismajli, Rexhep Mustafa, Valon Hiseni, Premtina Rakovica, Muhamet Nura, Vjollca Rizani, Ajnishahe Azemi, Mustafë Krasniqi, Arta Krasniqi, Luan Jusufi, Sali Krasniqi, Tefik Mehmeti, Shefki Gashi, Naime Osmani, Bajram Selimaj, Shefqet Sylejmani, Agim Krasniqi, Flamur Shala, Nexhmije Berisha, Aziz Pacolli, Milazim Vitia, Naim Makolli, Donika Surdulli, Nerxhivane Vitia, Sofije Kllokoqi, Shemsi Veseli, Skënder Reçica, Besa Halimi - Zagragja, Lumnie Rama, Meliza Haradinaj, Mejreme Berisha, Besa Rafuna, Kimet Zeqa, Feti Mehdiu dhe Sadri Ramabaja.

**Munguan:** Engin Beyoglu, Liridon Restelica, Sarandë Sadriu, Remzi Pacolli, Astrit Hasani dhe Afërdita Veliu.

**Morën pjesë përfaqësuesit monitorues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, përfaqësuesit e OJQ-ve, përfaqësuesit e mediave dhe përfaqësuesit e kompanive që do të bëjnë prezantimin e Planit zhvillimor komunal.**

**Mbledhjen e kryesoi dhe e udhëhoqi, Sami Hamiti Kryesues i Kuvendit,** duke cekur se është propozuar që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë: *"Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objekteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës"*.

**Agim Salihu** dha një sqarim reth pikës së propozuar.

**Me plotësimin e rendit të ditës, u konstatua se njëzëri u miratua ky**

### **R E N D I D I T Ë S:**

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë;**
- 2. Propozimvendimi për miratimin e Planit zhvillimor të komunës, për periudhën 2013-2022;**
- 3. Propozimvendimi për miratimin e Strategjisë së zhvillimit lokal ekonomik të komunës së Prishtinës, për periudhën 2013-2016;**

4. Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes "Tophane";
5. Propozimvendimi për rishikimin e buxhetit për vitin 2013;
6. Propozimvendimi përfundimtar për lokacionin e objektit të Kishës Katolike në Prishtinë;
7. Propozimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personit fizik/ juridik;
8. Propozimvendimi për pezullimin e procedurës së tenderimit për dhënien me qira të qoshqeve në qytet;
9. Propozimvendimi për vazhdimin e zbatimit të Rregullores dhe Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tatim në pronën e paluajtshme për vitin 2014;
10. Propozimvendimi për lejimin e fletëtransferit të mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Hortikultura" SHA, Prishtinë;
11. Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objekteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës;
12. Pyetje dhe përgjigje;
13. Të ndryshme.

#### Pika e parë

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tetë të Kuvendit

#### Pika e dytë

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin e Planit zhvillimor të komunës, për periudhën 2013-2022, kryesuesi tha se ky plan ka qenë më se dy muaj në diskutim publik, janë dhënë vërejtje, sugjerime dhe propozime dhe disa nga to që janë marrë si të arsyeshme, komisioni i cili është formuar, i ka analizuar dhe tani këtë material e kemi në variantin përfundimtar.

Para se kompania projektuese të fillojë me prezantimin e këtij plani, **Behxhet Musliu**, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtje së Mjedisit, i njoftoi të pranishmit rreth zhvillimit të procedurave me rastin e hartimit të këtij plani.

**Bujar Demjaha**, përfaqësues i kompanisë "Art Design", në mënyrë elektronike bëri prezantimin e këtij plani, duke elaboruar komponentet kryesore të tij, e në veçanti u fokusua rreth ndryshimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve, ku një pjesë e tyre edhe janë inkorporuar në tekstin final.

**Kryesuesi** hapi diskutimin rreth këtij plani.

**Mustafë Krasniqi**, në emër të GP të LDK-së, tha se e kemi shqyrtuar dhe analizuar Vendimin për miratimin e Planit zhvillimor komunal për periudhën 2013 - 2022. Mendojmë se është bërë një punë mjaft e mirë për hartimin e këtij plani zhvillimor, ku paraqitet profili i gjendjes së Komunës, pozitat, rëndësitë dhe çështjet tjera specifike, analiza e profilit, ku tregohen përparësitë, mangësitë dhe mundësitë e zhvillimit të komunës së Prishtinës, vizionet, caqet, prioritetet strategjike zhvillimore afatgjate.

Ne jemi të vetëdijshëm që në këtë projektplan mund të ketë gabime të vogla teknike, fotografike, rreth emërtimeve etj., andaj dhe kërkojmë që këto në të ardhmen të përmirësohen.

Ne si Grup parlamentar i LDK-së, e përkrahim dhe do ta votojmë për miratim.

**Milazim Vitija**, në emër të GP të AKR-së, tha se edhe ne si grup parlamentar e përkrahim Planin zhvillimor komunal dhe e votojmë për miratim.

**Shemsi Veseli**, në emër të GP të PDK-së, tha se para se të kalojë në debat publik, i kam paraqitur disa vërejtje dhe e kam vërejtur realisht që asnjëra gati prej atyre që ne i kemi dhënë nuk janë marr parasysh.

Plani zhvillimor komunal është dashur që të nisët prej tri parimeve, qëndrimeve kryesore, dhe ato që i parasheh ligji, është analiza e situatës urbane, plani dhe çështja tjetër strategjinë e zbatimit dhe për këtë strategji asgjë nuk ka, andaj konsideroj se nuk është në harmoni me ligjin.

Planifikimi duhet të bëhet në interes të qytetarëve, për interesin publik, dhe nëse flasim tash prapë nga aspekti procedural, unë nuk kam parë që është mbajtur asnjë mbledhje me Komitetin për planifikim, po ashtu nuk është dhënë asnjë mendim nga Këshilli i ekspertëve etj. Nuk ka përgjigje shumë të rëndësishme dhe nuk mund të anashkalohet, sepse ne jemi dëshmitarë të kohës me degradime dhe me kaosin urban që është bërë brenda këtyre viteve lidhur me problemet më të rënda rreth ndërtimeve të egra, të cilat përfshijnë rreth 50% të sipërfaqes së rajonit ekzistues ndërtimor. Mungon analiza e kostos së realizimit të këtij plani, mungon identifikimi i forcave shtytëse dhe pengesa e implementimit të objektivave të parashtruara, mungon modelimi i politikave të menaxhimit të tokës, mungon analiza në përgjithësi për planet, mbulimin e investimeve të ardhshme urbane, etapat e realizimit, rangimin, mandej detyrat prioritare etj. Nuk është dhënë asnjë sqarim tek ndarja e distrikteve të Prishtinës, nuk specifikohen edhe projektet se cilat duhet të jenë synim në kuptimin e zhvillimit të komunës, disi nuk e kanë një plan të veprimit apo të saktë, apo nuk tregojnë mënyrën se si do të financohen ose alternativat e mundshme, çka prapë tregon se nuk është punuar shumë seriozisht për realizimin e projekteve.

Duke i pasur për bazë të gjitha këto, këtë plan ne nuk do të votojmë për miratim.

**Meliza Haradinaj**, në emër të GP të AAK-së, tha se grupi i ekspertëve të AAK-së për Prishtinën e kanë analizuar këtë plan dhe kanë gjetur se këtë plan e përshkon një mosseriozitet i papranueshëm. Ajo çka e bënë të papranueshëm këtë plan është papërcaktueshmëria kohore, mungesa e planifikimeve dhe implikimeve buxhetore, të dhëna të gabuara sasiore dhe cilësore, krahasimet e gabuara në shumë fjali dhe paragrafë të pakuptueshëm.

Si pikë e parë, ky plan është bazuar në numër jo zyrtar të popullsisë, ku paraqiten afatet kohore dhe implikimet financiare, ku ne arrimë të shohim një plan buxhetor i cili nuk e përmban asnjë numër të vetëm, përveç përmendjes së institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, nuk tregohet më shumë se si do të jetë korniza e saktë financiare.

Ky plan në tërësinë e tij përmban krahasime të gabuara dhe jo logjike, duke përmendur shembuj konkret, si p.sh. të unazave etj.

Janë marr shembuj nga Evropa rreth transportit të mallrave, ku të gjitha këto krahasime nuk konsistojnë me zhvillimin ekonomik të Prishtinës, dhe i konsiderojmë si shumë të gabuara. Ky plan gjithashtu përmban gabime të shumta gramatikore, sintaksore dhe morfologjike, të cilat e përshkojnë në tërësi.

Si përfundim, ne konsiderojmë se ky plan është një përmbledhje shumë e dobët e planeve të tjera dhe nuk përputhet aspak me realitetin e Prishtinës.

Për të gjitha këto arsye, ne si Grup parlamentar i AAK-s nuk do ta votojmë këtë plan.

**Feti Mehdiu**, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se në parim do ta përkrahim këtë plan, megjithëse pajtohem me shumë prej sugjerimeve që u dhanë nga parafolësit. Veçanërisht për ne, do të ishte shumë i dobishëm në raportin tonë që i kemi me qytetarët që na kanë votuar dhe ato shifra dhe ajo analiza e 600 kërkesave të ndryshme, 17 të analizuara disa të zgjedhura, disa ende në proces, do të ishte mirë t'i kishim me vete se nuk i kishim këtu.

Konceptit të kulturës, konkretisht trashëgimisë kulturore, pak po i kushtohet, se objektet kulturore që i ka Prishtina nuk janë me rëndësi vetëm për Prishtinën, por janë të Kosovës, mendoj se do të ishte mirë që ta përfshinte edhe atë.

Me rastin e restaurimit të objekteve kulturore, duhet të kihet parasysh që të ruhet origjinaliteti i tyre, rast konkret e kemi modelin e Hamamit të Prishtinës, pra kemi edhe objekte tjera në Prishtinë me vlerë kulturore të cilat duhet t'i ruajmë.

**Besa Rafuna**, në emër GP të LDD-së, tha se meqë ky propozimplan dy muaj ka qenë në diskutim publik, konsideroj se ka pasur kohë të mjaftueshme që secili të marrë pjesë dhe ta japë kontributin e vet në secilën formë si profesionale, ashtu edhe në forma të ndryshme. Pajtohem me diskutimin e z. Veseli se është dashtur që kritikant ose sugjerimet e qytetarëve të jenë pjesë e këtij vendimi.

**Shefki Gashi** tha se për ta përcaktuar mënyrën e rregullimit administrativ të territorit të Prishtinës, është dashur kaheerë të miratohet Ligji për Prishtinën, sepse në propozimvendimin është preambula, e cila i citon nenet e ligjeve të miratuara, të cilave iu përmbahet ky plan. Ky ligj i cili ka mbetur si i tillë që sa vite, po sjell shumë probleme, shumë parregullsi, shumë të meta për kryeqytetin e Kosovës. Kjo është një shkelje e drejtpërdrejtë e interesit të përgjithshëm të qytetarëve jo vetëm të Prishtinës, por të Kosovës, që në mënyrë permanente të manipulohet me një akt juridik, i cili është i domosdoshëm dhe nuk është pronë e askujt, nuk është pronë e asnjë individi, nuk është pronë e asnjë grupi partiak të asnjë partie politike, por është e drejtë e të gjithë qytetarëve të Kosovës që të trajtohen në mënyrë sa më reale.

Sa i përket mbulesave financiare, vërehet se këtu në përmbajtjen ose fillimin e këtij projekti, qenka një numër i mjaft ekspertëve.

**Sadri Ramabaja**, në emër të Lëvizjes Vetvendosje (VV), tha se Prishtina me këtë qeverisje komunale është shndërruar në peng të grupeve të ndryshme të interesit dhe pronarëve të parcelave tokësore. Edhe në këto propozimvendime, që duket të insistohet të shndërrohen në akte nënligjore të obligueshme për qytetin, në dokument vërehet qartë se nuk është përfillur elementi i progresit ekonomik dhe drejtësisë sociale, për të mos folur për shije socio-estetike urbane, për të cilat duket se jemi jashtëzakonisht larg me dritën e diellit. Përmes këtij reagimi, këtu në këtë sallë të Kuvendit, ku mendoj se do të duhej të

debatohej shumë më gjatë rreth kësaj, ne mendojmë se pushteti aktual i Komunës, me pretendimin që një muaj para ikjes të ruajë interesat dhe përfitimet private pas largimit nga pushteti, nuk do duhej të kalonte.

E dyta, kjo qasje bie ndesh me konceptet e demokracisë moderne që merr në konsideratë mendimin e përparuar shkencor ekonomik.

Në dokument vërehet se nuk është marrë në konsideratë mendimi i përparuar shkencor ekonomik dhe vërehet shumë hapur se dokumenti, sidomos ky i planifikimit, është në përputhje të plotë me interesat e grupeve të interesit.

Në rast se do të miratoheshin, nëse pra nuk shkohet tutje dhe insistohet me çdo kusht që këto propozimvendime shndërrohen në vendime, në akte nënligjore, ne nuk do të jemi pjesë e kësaj maskerade politike, dhe iu bëj thirrje opozitarëve që përfundimisht të tregohen në nivel të përgjegjësisë që kanë në mbrojtje të interesit të qytetit për mbrojtjen e së ardhmes së Prishtinës.

**Besa Halimi - Zagragja** ceku disa shembuj konkret që lidhen me rritjen e hapësirave të gjelbra, shtigjet për biçikleta, numrin e parkingjeve për banim etj. që jepen në dokument. Vendparkingjet janë një prej pikave që vërtet japin sinjale se a është nisur ky plan në gjendjen aktuale. Sa janë këto standarde që janë dhënë këtu, sa ofrohen me ato plane që i kemi miratuar ne, me ato plane urbanistike që i kemi miratuar ne deri më sot, me gjendjen reale në kryeqytet, prandaj desha të bëj pyetjen. Këtij plani është dashtur t'i bëhet analizë më e thellë, më reale, konstatim i gjendjes faktike për të bërë një plan, i cili pastaj do të mund të krahasohej jo me vende shumë të larta dhe të zhvilluara, por së paku me Tiranën dhe Shkupin që i kemi shumë afër. Unë nuk e di si mund të besojmë se do të ketë një realizim sipas këtyre standardeve, duke e parë gjendjen reale të sotme.

**Hetem Kupina** tha se të gjitha vërejtjet, këshillat dhe sugjerimet e mia i kam dhënë në takimet me qytetarë, mirëpo jam i obliguar që në emër të qytetarëve të Bashkësisë Lokale të Bardhoshit, t'i shprehi mirënjohjet dhe falënderimet e pa përshkruara ekzekutivit komunal, Drejtorisë së Urbanizmit dhe hartuesve të këtij plani për mundësinë e ofruar që iu është ofruar qytetarëve, që edhe ata të njoftohen me planin zhvillimor që, edhe ata të japin këshillat dhe sugjerimet e tyre.

**Vjollca Dibra** tha se në mënyrë të detajuar është bërë një analizë, ku lirisht mund të themi se është respektuar në përpikëri, dhe ky dokument është në nivel me planet zhvillimore që hartohen nga kryeqendrat e tjera evropiane.

Për ta lavdëruar këtë punë që është bërë, mendoj se është një punë shumë e madhe. Besoj se gjatë hartimit këtij plani edhe opozita ka pasur opinionet, sugjerimet dhe rekomandimet e veta, duke menduar se ky plan ka pasur rreth 21 debate publike, ka qenë edhe pjesë e miratimit në Kuvend komunal në herën e parë si draft.

Sa i përket asaj që thotë Meliza se nuk kemi papërcaktueshmëri kohore, unë habitem se përcaktueshmëria kohore jepet qysh në fillim, 2013 - 2022, prandaj unë çuditë se ku është ajo papërcaktueshmëri kohore. Pastaj, sa punë është bërë në kryeqytet, me të cilën Meliza shprehi pakënaqësinë e vet. Unë dhe shumë të tjerë besoj se po të duam të shohim, janë shumë të dukshme, të prekshme rezultatet që i kemi arritur këtu, duke u nisur nga eliminimi i ndërrimit të tretë nëpër shkollë, po thuajse se më nuk kemi askund ndërrim të tretë. Duke u nisur nga ndërtimi i shumë sallave dhe fushave sportive, duke u

nisur nga ajo që në çdo lagje kemi parqe, d.m.th. nuk ka lagje që nuk ka ndonjë park dhe gjithë ata drunj të mbjellë dhe numri i hapësirave të gjelbëruara është në rritje e sipër, që do të thotë se është bërë një punë shumë e madhe në këtë drejtim.

**Aziz Pacolli** shtroi dy pyetje rreth këtij projekti: Kërkoj të di se a ka ndonjë ndërrim prej fillimit, që kemi thënë që Gërmia të jetë e tërësishme dhe, e dyta, se në cilat pjesë të qytetit ka pasur vërejtje më shumë nga qytetarët dhe a janë aprovuar ato në ato pjesë.

**Prof. dr. Isa Mustafa**, Kryetar i Komunës, tha se jemi të vetëdijshëm se është fjala për dokumentin i cili meriton të diskutohet. Për këtë plan presim të ketë vërejtje, sugjerime dhe propozime, i cili nuk është i përkryer, sepse gjithmonë mbetet diçka që të plotësohet. Ka pasur gabime shumë më të mëdha në fillim, ne kemi diskutuar bashkarisht me përfaqësuesit e subjekteve politike, këtu njëherë e kemi diskutuar gjatë, pastaj janë bërë ndryshime mjaft të mëdha, sigurisht ka vend edhe më tutje që të ishin bërë korrigjime, mirëpo është një plan në të cilin është punuar tash e 14 muaj.

Janë dhënë edhe vërejtje prej qytetarëve. Mund të them se këto vërejtje që kanë qenë, pjesa dërmuese e tyre është lidhur me Planin zhvillimor urban, një pjesë është lidhur me Planin zhvillimor komunal, por kryesisht është fjala për parcela private, për të cilat qytetarët kanë shprehur interesimin e tyre se çfarë do të ndodhë me ato parcela. Ky është një dokument shumë i rëndësishëm, i cili mbron interesat e Komunës e jo interesat e individëve.

Unë në këtë plan shoh një interes shumë të madh të Prishtinës, që Prishtina ta ketë një Plan zhvillimor komunal, që ne ta dimë se si do të zhvillohet Prishtina në të ardhmen në pikëpamje hapësinore dhe urbane, edhe në territorin urban të cilin e kemi zgjeruar tash me këto dy plane.

Unë jam i bindur që ne i kemi arritur dhe i kemi kryer të gjitha punët që ne është dashur t'i përfundojmë, andaj unë ju lus që ta votoni, sepse ky plan nuk është plan zhvillimor i një subjekti, por është plan zhvillimor i një kryeqyteti, plan zhvillimor i cili hap perspektiva të reja të zhvillimit hapësinor dhe urban të Prishtinës edhe si kryeqytet, edhe si Komunë, dhe të gjithë duhet të angazhohemi në mënyrë që ai të zbatohet.

Për vërejtje dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, **Bujar Demjaha** dha sqarieme të nevojshme.

**Me katër vota kundër ( Shemsi Veseli, Lumnije Rama, Besa Halimi- Zagragja dhe Skënder Reçica), u miratua Vendimi për miratimin e Planit zhvillimor të komunës për periudhën 2013-2022;**

**Pika e tretë**

**Lidhur me Propozimvendimin për miratimin e Strategjisë së zhvillimit lokal ekonomik të komunës së Prishtinës për periudhën 2013 - 2016, kryesuesi hapi diskutimin**

**Avdullah Hoti** tha se ky material është punuar nga një grupi ekspertësh të fushës së ekonomisë, pasi që kjo strategji merr parasysh Planin zhvillimor komunal, Planin zhvillimor urban, planet rregulluese dhe aspektet tjera të zhvillimit urban të qytetit, për

t'i transferuar në një strategji që koncentrohet më shumë në zhvillimin ekonomik të qytetit në periudha më të gjata. Strategjia i referohet periudhës 2013 - 2016, por me tendenca që të hapen mundësi për zhvillim shumë më afatgjatë. Në fakt, një listë e gjatë e projekteve që janë paraparë në Strategji, nuk janë projekte që kompletohen ose që i referohen vetëm kësaj periudhe kohore, por shkojnë përtej saj.

Ne i kemi diskutuar me përfaqësuesit e subjekteve politike në disa diskutime që i kemi pasur, me diskutime publike, nëpër forume të ndryshme, me grupe të ndryshme të interesit, dhe kemi ardhur me një listë shumë të gjatë të projekteve. Ajo që është vlerë e shtuar e kësaj strategjie, është që të parashihet mënyra se si do të zbatohen këto projekte. Mendoj se edhe kjo strategji do të krijojë bazë shumë të mirë që të zhvillohen buxhete komunale në katër vitet e ardhshme, që janë të zbatueshme edhe që i adresojnë nevojat e qytetarëve.

**Besnik Krasniqi**, përfaqësues i konzorciumit ISB-DND, prezantoi Strategjinë e zhvillimit lokal ekonomik për komunën e Prishtinës, ku kryesisht u fokusua në përmbajtjen kryesore të saj, që përfshinë vizionin, synimet, projektet dhe koston e këtyre projekteve. Strategjia e zhvillimit lokal e komunës së Prishtinës për 2013- 2016, përbën një bazë të mirë dhe një hap shumë të rëndësishëm për të krijuar atë që vizioni i kësaj strategjie Prishtinën e paraqet si një kryeqytet me tipare evropiane, e njohur me zhvillimin ekonomik, me urbanizëm bashkëkohor dhe shërbime efikase, e integruar në zhvillimet rajonale ndërkombëtare, qendër e jetës së begatshme kulturore, arsimore e sportive, me shërbime të fuqishme intelektuale, financiare dhe jetë cilësore për të gjithë qytetarët.

**Tefik Mehmeti**, në emër të GP të LDK-së, tha se kjo pikë e rendit të ditës është e një rëndësie të veçantë, sepse jep korniza buxhetore të planifikuara për një periudhë afatmesme, si të hyrat ashtu edhe të shpenzimet. Pra, do të kemi një pasqyrë mbi të hyrat dhe shpenzimet, apo realizimin e projekteve deri në vitin 2016 dhe më tutje.

Këtë strategji duhet ta ndajmë në dy pjesë. Pjesa e parë është një informatë apo pasqyrë për periudhën e kaluar katërvjeçare mbi të hyrat dhe shpenzimet, ndërsa në pjesën e dytë analizohen dhe përcaktohen objektivat e zhvillimit të komunës së Prishtinës, me këtë buxhet të vogël që ka në periudhën e cekur, ku në të janë të paraqitura të gjitha mundësitë e realizimit të të hyrave, si dhe investimet që planifikohen të realizohen në të gjitha fushat.

Si GP mendojmë se kjo strategji është e punuar mirë dhe ka një harmonizim të arsyeshëm të qëllimit, mundësive dhe objektive të zhvillimit për këtë periudhë të caktuar.

**Aziz Pacolli**, në emër të GP të AKR-së, tha se vërtet është një strategji ku kemi marr pjesë edhe ne, kështu që edhe vërejtjet tona ato që i kemi pasur janë inkorporuar në këtë strategji. Këtë dokument e përkrahim për miratim.

**Shemsi Veseli**, në emër të GP të PDK-së, tha se e kemi analizuar këtë strategji dhe mendoj që kjo është hartuar prej një ekipi të mjaftueshëm të ekspertëve dhe e vlerësojmë punën që është bërë, por edhe përkundër kësaj, kemi vërejtje dhe sugjerime.

Thuhet se projektet e synuara thirren në mekanizmat, por cilët janë mekanizmat me të cilët synohet zhvillimi i Prishtinës. Për realizimin e buxhetit në periudhën 2008 - 2012, programi thjesht jep të dhëna për shifra të shpenzuara sipas linjave buxhetore, por tabela

nuk ofron se çfarë është zotuar për secilën linjë buxhetore. Sa i përket bizneseve, aty ka vetëm përshkrime. Për zhvillimi rural, mendoj se ka një përshkrim të gjendjes ekonomike në zonat rurale, por nuk ka përshkrim të rrethanave pak a shumë më detaje edhe klimatike, gjeografike etj.

Për infrastrukturën lokale, që është një ndër elementet kyçe në zhvillimin ekonomik, jepet një tabelë që pasqyron investimet e infrastrukturës. Mendoj se aty krijohet terreni i dyshuar që ka keqpërdorim. Mungon një lidhshmëri mes arsimit, kulturës me zhvillimin ekonomik, po ashtu është dashur që të bëhet një përshkrim i rrethanave të shëndeti publik dhe mirëqenia sociale rtj.

Duke pasur për bazë të gjitha këto, këtë strategji nuk e votojmë për miratim.

**Mejreme Berisha**, në emër të GP të AAK-së, tha se kjo strategji e zhvillimit ekonomik lokal të Prishtinës, dhashtë Zoti vetëm të mos jetë një dëshirë në letër, por le të realizohet. Mirëpo unë e kisha bërë një renditje të prioriteteve të kësaj. Unë arsimin e shoh si prioritar, sidomos për kryeqytetin tonë. Më brengos një gjë te arsimit, se aty thuhet “për trajnimin e personelit arsimor”, nuk e kam të qartë çfarë trajnimesh, pse ato të holla të mos shkojnë në lokacione për shkolla, për çerdhe. Po ashtu, edhe çështja rurale mund të jetë një prioritet, sepse ne nuk kemi bërë asgjë ndoshta për fshatrat e Prishtinës, pra kemi dhe probleme të tjera, si me trotuaret etj., andaj e përkrah si vizion dhe uroj që këto pikat të jenë jo vetëm dëshira, por të realizohen.

**Feti Mehdiu**, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se në parim do t'i japim përkrahje këtij dokumenti, që njëherësh duke e përkrahur edhe mendimin e znj. Berisha që diskutoi rreth çështjes së arsimit, se arsimin asnjëherë nuk e kemi vënë në vend të parë, apo të dytë, gjithnjë ka mbetur i teti, i nënti, i dhjeti.

Kam edhe një sugjerim se gjuha njëmend në shumë vende na pengon në këto dokumente, por unë u ndala bash te arsimit. Kur flitet për arsimin, le të kenë shumë kujdes ata që i përkthejnë tekstet, pasi që nganjëherë fjalitë duken shumë banale, pra t'i kenë parasysh këto. Këtë dokument e përkrahim për mirtim.

**Besa Rafuna**, në emër të GP të LDD-së, tha se e përgëzoi ekspertin e ekonomisë që na ka sjellë një strategji të detajuar dhe shpresoj se do të realizohet me sukse, edhe pse kostoja është shumë e madhe.

**Besa Halimi - Zagragja**, tha se aty ku konstatohet gjendja e mesatares së nxënësve nëpër klasa, duke dhënë një shifër, që për mendimin tim si pjesëmarrëse në arsim do të ishte ideale sikur të ishte kështu, me 25 nxënës në nivel të ulët dhe 32 në nivelin e mesëm të lartë. Këto shifra do të ishin shumë të mira sikur të ishin kështu, por këto janë një mesatare e dy problemeve të mëdha të klasave të mbingarkuara dhe të klasave të vogla.

Prandaj, sa herë që flisni për këtë problem, ju lutem shtojeni edhe një fjali që ta paraqitni gjendjen reale lidhur me këtë, sepse pastaj rrjedhimisht nuk është bërë strategji lidhur me zgjidhjen e këtij problemi. Unë e di që strategjia e arsimit e ka trajtuar këtë çështje atje, por edhe këtu me implikime ekonomike do duhej të përfaqësohej si problem.

**Flamur Shala** tha se ky dokument është i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Prishtinës në trevjetshin e ardhshëm. Ky dokument arsyeton disa kërkesa që ka Plani zhvillimor, të cilin posa e miratuam. Po të mos ishte kështu, ndryshe nuk do të kishte kuptim as Plani zhvillimor, as kjo strategji, por këto lidhen edhe ndërlidhen shumë. E



kam krahasuar me Strategjinë 2008 - 2011, dhe shoh se kjo strategji është vazhdim i punëve dhe projekteve, të cilat duhet të qojnë drejt zhvillimit të Prishtinës sipas vizionit dhe synimeve që i ka vet komuna, d.m.th. është një ndërlikim.

Është fakt se ne e kemi miratuar një strategji ose një plan zhvillimor të arsimit të komunës së Prishtinës 2013 - 2016, i cili plan ka një 3-4-5 fusha të rëndësishme, të cilat duhet të zhvillohen, në mënyrë që arsimit të shkojë drejt zhvillimit të tij në kuadër të zhvillimit të kryeqytetit. Një nga ato fusha është edhe infrastruktura. Brenda kësaj fushe parashihen të zhvillohen disa projekte, siç janë zgjerimi i hapësirave shkollore, pajisja me laborator, me mjete mësimore etj.

Disa projekte që kanë qenë të miratuara qysh në Strategjinë 2008 - 2011, në bashkëfinancim me Qeverinë, ato projekte nuk janë realizuar, bie fjala "unaza e

brendshme" ose "unaza e jashtme", të cilat sot e asaj dite janë peng të qasjes jo të mirë ndaj Prishtinës. Kryeqyteti ynë ka pësuar më së shumti për shkak të qasjes së gabuar që ka pasur qeveria ndaj tij, andaj kjo duhet të ndryshojë. Ne si këshilltarë duhet të kërkojmë që të ndërrojmë, pavarësisht se kush do të jetë nesër apo pasnesër, dhe unë mendoj se do të jenë ata që janë më të merituarit.

**Me dy vota kundër ( Shemsi Veseli dhe Lumnije Rama) u miratua Vendimi për miratimin e Strategjisë së zhvillimit lokal ekonomik të komunës së Prishtinës për periudhën 2013-2016.**

#### **Pika e katërt**

**Për Propozimvendimin për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes "Tophane", Behxhet Musliu** paraqiti arsyetimin për ndryshimin e këtij plani.

**Musli Meha**, në emër të GP të LDK-së, tha se këtë propozimvendim e kemi analizuar dhe shqyrtuar me vëmendje të veçantë dhe, pas arsyetimit dhe diskutimit të zhvilluar në këtë grup, është marrë vendim që të përkrahet në tërësi ky propozimvendim.

**Aziz Pacolli**, në emër të GP të AKR-së, tha se pas çdo kërkesë për ndryshime të planeve, vërtet është një kërkesë e jona që mos të jenë pas çdo pesë vjetëshi i pa implementuar ai projekt, por le të mendohet dhe le të punohet mirë që në terren të jetë i implementueshëm në të ardhmen.

**Besa Halimi - Zagragja**, në emër të GP të PDK-së, tha se edhe pse nuk kam informacion se çfarë qëndrimi kemi marrë, besoj që do të duhej të ishte për miratim.

**Mejreme Berisha**, në emër të GP të AAK-së, përkrahu miratimin e këtij plani.

**Feti Mejdiu** në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se edhe ne e përkrahim, sidomos kur e shohim që kanë parasysh ta shqyrtojnë edhe njëherë ndërtimin e blloqeve, që të ju ikin komplikimeve të mëvonshme. E përkrahim këtë plan për miratim.

**Sadri Ramabaja**, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje (VV), tha se nuk e di sa ka mundësi që të korrigohet krejt ajo çka ka ndodhur atje. Para tri vitesh isha në Vatikan edhe pash që rrugicat e mesjetës që i ruajnë me xhelozzi ata me qëllime thjesht arkeologjike, historike, kulturore etj., janë gati thuajse të ngjashme me këto në Tophane, e besa besë edhe te Lagjja e Spitalit etj, kështu që ne natyrisht që jemi për ndryshim, për ndërhyrje, për përpjekje për me shpëtuar çka është, por nuk mundemi të mos e potencojmë edhe faktin që përgjegjësia e këtij Kuvendi është shumë e madhe për atë çka po ndodh në Tophane.

**Besa Rafuna**, në emër të GP të LDD-së, tha se edhe ne e përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

**Njëzëri u miratua Vendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes "Tophane.**

**Pika e pestë**

**Lidhur me Propozimvendimin për rishikimin e buxhetit për vitin 2013, Xhelil Bektashi** paraqiti arsyetimin.

**Ajnishahe Azemi**, në emër të GP i LDK-së, tha se si grupi parlamentar kemi shqyrtuar këtë vendim për rishikimin e buxhetit për vitin 2013, dhe duke pasur parasysh që me këtë vendim mjetet ridestinohen në kategori buxhetore sipas nevojave të komunës, për investime kapitale, subvencione dhe transfere, mendojmë se ky vendim duhet të miratohet.

**Aziz Pacolli**, në emër të GP të AKR-së, tha se në fakt është një punë profesionale e drejtorisë. Si grup parlamentar, e kemi analizuar dhe shqyrtuar këtë propozimvendim, kështu me të gjitha vërejtjet që janë dhënë edhe prej partive opozitare, andaj mendoj se duhet të kalojë.

**Shemsi Veseli**, në emër të GP të PDK-së, tha se do të ishte mirë që të jepej një sqarim, meqë këto mjete po merren prej këtyre zërave buxhetorë dhe kemi të bëjmë tash me programin e administratës së përgjithshme që merren nga zërat grand këto furnizimi me automjete dhe kjo a do të vazhdojë, apo do të ndërpritet. Në parim, meqë ka shkuar edhe përpara dhe e kam parë në tabela, ku dhe janë dhënë sqarimet se ku do të shkojnë mjetet që mos me krijohet një lloj amullie, këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

**Mejreme Berisha**, në emër të GP të AAK-së, e përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

**Feti Mehdiu**, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, e përkrahim për miratim këtë propozimvendim.

**Sadri Ramabaja**, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje (VV), e përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

**Besa Rafuna** në emër të GP të LDD-së, tha se këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

**Njëzëri u miratua Vendimi për rishikimin e buxhetit për vitin 2013.**

## Pika e gjashtë

**Lidhur me Propozimvendimin përfundimtar për lokacionin e objektit të Kishës Katolike në Prishtinë, për propozimin përfundimtar të këtij objekti, të pranishmit i njoftoi Agim Salihu.**

**Mustafë Krasniqi**, në emër të GP të LDK-së, kërkoi që sa më parë të caktohen pikat, në mënyrë që hapësira që është uzurpuar me mbjelljen e drurëve, të lirohet menjëherë dhe të caktohet ku është prona komunale.

**Aziz Pacolli**, në emër të GP të AKR-së, tha se vërtetë është një pikë shumë e ndieshme dhe kam kërkuar që të jetë më e qartë skica, me metrat të cilat i jepen Katedrales. Kërkoi që vendimet e Kuvendit komunal të respektohen në përpikëri. Është e rrugës që pas aprovimit të kësaj pike, të dilet dhe t'ju thuhet qytetarëve se lokalet do të ndërtohen prapë në ato sipërfaqe çfarë kanë qenë të ndërtuara.

**Shemsi Veseli**, në emër të GP të PDK-së, e përkrahu propozimvendimin, por kërkoi që sipërfaqja e këtij lokacioni të definohet saktë.

**Mejreme Berisha**, në emër të GP të AAK-së, kërkoi të dijë se në fillim kur është propozuar ky lokacion, a është ditur se sa arë ka ajo pjesë dhe nëse nuk është ditur, faji është i organeve të komunës, megjithatë në parim edhe ne e përkrahim për miratim.

**Feti Mehdiu**, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se edhe ne e përkrahim këtë propozim me ato sugjerime që të saktësohen punët si duhet, që mos të ketë probleme në të ardhmen. Sugjeroi që të bëhet një harmonizim rreth emërtimit, të jetë kishë apo katedrale, por të kihet parasysh se duhet me qenë katedrale.

**Sadri Ramabaja**, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje (VV), tha se nuk e di si është menduar në planin urbanistik për atë lagje, a është menduar që të iu jepen pikërisht aty ato objekte atyre punëtorëve që kanë punuar aty apo jo, kështu që unë e kam vështirë të mendoj se është zgjidhje për interesat e nëntë qytetarëve apo dhjetë, apo sa janë aty, që të ndërhyhet dhe prapë të ndërtojnë objekte të vogla afër Katedrales. Mendoj se Kadastrri ka qenë i papërgjegjshëm atëherë, i ka ofruar shënime jo të sakta. Për këtë do duhej të mendonim pak më gjatë në këtë drejtim, të mos lejojmë që nesër të pendohemi për votimin e sotëm. Kjo është arsyeja që e hedh në pikëpyetje arsyeshmërinë e votimit kështu si është propozuar.

**Besa Rafuna**, në emër të GP të LDD-së tha se edhe ne e ndajmë po të njëjtin mendim me z. Ramabaja.

**Prof. dr. Isa Mustafa** tha se jemi ballafaquar me një situatë pak paradoksale sa i përket këtij lokacioni. Propozimi për lokacionin e parë prej 1.30 ha, nuk ka mundur të realizohet, nuk është pranuar nga Katedralja, dhe më vonë është ropozuar parcela te ish-Gjimnazi, parcelë e pa ndarë. Në 1.3 hektarë d.m.th, ka qenë parcela, për arsye se dokumentacion kadastral nuk e kemi, është në Sërbi, edhe nuk ka pasur dokumentacion që e ka ndarë atë parcelë. Kuvendi kur ka marrë vendimin për ndarjen e asaj parcele d.m.th. në atë parcelë ka hyrë edhe trotuari vizavi Fakultetit Filologjik deri në rrugë, janë semaforët dhe sheshi "Bill Clinton" që e përfshinë edhe objektin e Administratës Tatimore. Kur është dhënë leja nga urbanizimi, pas atij vendimi që ka marrë Kuvendi në vitin 2007, që e ka saktësuar se janë 68.11 arë, atëherë leja ndërtimore e Katedrales është dhënë në 68.11 arë, dhe është

llogaritur në hapësirën që është ndërtuar katedralja. Tash pretendimet janë se ata kanë pronësinë ose të drejtën pronësore mbi 1.30 arë, gjendja faktike është se katedralja është ndërtuar në oborrin e shkollës "Xhevdet Doda" dhe se ai oborr ka qenë oborr i definuar për ndërtimin e katedrales, ndërkaq me planin rregullues të asaj pjese është saktësuar se do të ndërtohen ato lokale, të cilat nuk e prishin oborrin e katedrales, sepse është denivelimi, do të thotë duken nga pjesa perëndimore, por në pikëpamje të oborrit të katedrales nuk prishin asgjë. Me matjen e fundit gjeodezike ka rezultuar se ajo parcelë i ka 68.14 arë dhe kjo është gjendja faktike në terren.

**Me dy abstenime ( Sadri Ramabaja dhe Besa Rafuna), u miratua Vendimi përfundimtar për lokacionin e objektit të Kishës Katolike në Prishtinë.**

#### **Pika e shtatë**

**Lidhur me Propozimin për këmbimin e pronës së pa luajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personit fizik – juridik, arsyetimin për këtë propozim e paraqiti Agim Salihu.**

**Mustafë Krasniqi**, në emër të GP të LDK-së, tha se e përkrahim këtë propozimvendim, por në një të ardhme besoj që edhe pronat e të tjerëve do t'i kemi para vetes për shqyrtim.

**Aziz Pacolli**, në emër të GP të AKR-së, tha se parcelat të cilat sot i kemi para vetes dhe po i shqyrtojmë, ajo tokë është blerë më se tre herë nga Komuna, dhe tash ne ngrijmë dorën për tjetërsim të pronës. Kërkoj që të verifikohet ai dokumentacion, jo vetëm për këto prona, por edhe për pronat tjera në atë lokacion, prandaj dhe nuk e votoj këtë propozim.

**Shemsi Veseli**, në emër të GP të PDK-së, tha se me që këto dokumentacione nuk janë të verifikuara dhe duke pasur parasysh se ka edhe shumë qytetarë të tjerë që kanë prona të tilla, unë do të votoj kundër këtij propozimi.

**Mejreme Berisha**, në emër të GP të AAK-së, tha se edhe ne jemi kundër këtij propozimi dhe nuk e votojmë.

**Feti Mehdiu**, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se meqë situata është pak e komplikuar, ne do të abstenojmë.

**Sadri Ramabaja**, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje (VV), tha se po t'i referohemi Ligjit për pushtetin lokal, ky propozim del kundër këtij ligji, andaj kjo pikë e rendit të ditës, sipas atij ligji, nuk do duhej të sillej fare këtu. Besoj se gjashtë muaj para përfundimit të mandatit, vendimet për këmbim pronash janë të jashtëligjshme. Prandaj, bëjë thirrje që të tërhiqet krejtësisht, as të mos diskutohet e as mos të hidhet në votim.

**Me gjashtë vota kundër ( Shemsi Veseli, Mejreme Berisha, Lumnije Rama, Sadri Ramabaja, Aziz Pacolli) dhe dy abstenime ( Feti Mehdiu dhe ..... ), u miratua Propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së pa luajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në peronësi të personit fizik – juridik.**

#### **Pika e tetë**

**Lidhur me Propozimvendimin për pezullimin e procedurës së tenderimit për dhënien me qira të qoshqeve në qytet, arsyetimin për pezullimin e procedurës e paraqiti Agim Salihu.**

**Njëzëri umiratua Vendimi për pezullimin e procedurës së tenderimit për dhënien me qira të qoshqeve në qytet.**

#### **Pika e nëntë**

**Për Propozimvendimi për vazhdimin e zbatimit të Rregullores dhe Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tatim në pronën e paluajtshme për vitin 2014, arsyetimin rreth ndryshimit dhe plotësimit të kësaj rregulloreje e paraqiti Agim Salihu.**

**Aziz Pacolli kërkoi një sqarim rreth kamatës në tatim. Po ashtu kërkoi që të tentohet që ky Kuvend të nge zërin rreth kësaj kamate të tatimit.**

**Njëzëri u miratua Vendimi për vazhdimin e zbatimit të Rregullores dhe Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tatim në pronën e paluajtshme për vitin 2014.**

#### **Pika e dhjetë**

**Lidhur me Propozimvendimin për lejimin e fletëtransferit të mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Hortikultura" SHA, në Prishtinë, Xhelil Bekteshi tha se është propozuar që kësaj ndërmarrjeje t'i jepen mjete në shumën 300.000 €, për mbjelljen dhe kultivimin e drurëve dekorativë.**

**Njëzëri u miratua Vendimin për lejimin e fletëtransferit të mjeteve ndërmarrjes publike lokale "Hortikultura" SHA, në Prishtinë.**

#### **Pika e njëmbëdhjetë**

**Për Propozimvendimin për anulimin e Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objekteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, arsyeshmërin për anulimin e këtij vendimi e paraqiti Agim Salihu.**

**Njëzëri u miratua Vendimi për anulimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objekteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.**

**Pika e dymbëdhjetë dhe e trembëdhjetë  
Pyetje, përgjigje dhe të ndryshme**

**Shemsi Veseli** shprehu kënaqësi që janë kthyer disa prej punëtorëve që kanë qenë të larguar dhe është dëshmuar se janë të pafajshëm, siç ka qenë rastit me punonjëset Dritën dhe Sabilen, unë po flas në bazë të letrave dhe të disa të tjerëve, dhe më gëzon fakti se nëse ka pasur fakte, deri tash do të duhej dëshmuar. Po them përshëndes vërtetësinë e tyre që janë të pafajshme, që kanë qenë të pafajshëm, se nëse ka pasur ndonjë dëshmi e nuk ua kanë qitur, atëherë është faji i tjetërkujt.

E dyta, unë i pata potencuar disa gjëra, në procesverbal u patën përfshi, dhe në transkript e di që kanë qenë, por asnjë përgjigje nuk e kam marr. Ka qenë çështja e devijimit të rruga "B", është çështja që pata kërkuar prej drejtorit Xhelil Bekteshi edhe të tjerëve, pronat që i patëm qitur, pat dalë prej rendit të ditës, realisht çka është puna me to. Ata njerëz janë duke vazhduar punën, disa prej tyre kanë qitur dofarë letrash që kanë marr, prandaj edhe këtu nuk kam marr përgjigje, nuk kam marr përgjigje edhe te çështja e lokalit atje, që e pata ngritur te çështja e "Dardanisë", edhe me fotografi pat qenë bile, dhe inspekcioni nuk më ka dhënë përgjigje, megjithatë po anashkalohen do përgjigje, prandaj kërkoj që të më kthehen përgjigjet.

*Kryeuesi edhe një herë i luti drejtorët e drejtorive që përgjigjet për pyetjet e parashtruara, këshilltarëve t'iu kthehen me kohë, pasi që me ligj janë edhe të obliguar.*

**Aziz Pacolli** edhe kësaj radhe ngriti shqetësim rreth realizimit të projektit në Tauk- bahçe, me ç'rast pyeti se sa kub beton dhe sa kamion asfalt kanë hy në atë të ashtuquajturën "mrekulli" të Tauk-bahqes.

#### **Hetem Kupina, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Administratës**

Para disa muajve keni marrë vendim për meremetimin e objekteve të bashkësive lokale, në mesin e tyre të Bashkësisë Lokale të Bardhoshit. Besoj se kjo është shumë e vërtet. Sot kuptova që qenka anuluar ai vendim, kështu kuptova nga një zyrtar i juaj. Unë do të ju lutsha edhe nëse nuk bëhet meremetimi, së paku të rregullohen disa tjegulla lart se po pikon objekti, në mënyrë që të mos shkatërrohet ai objekt.

#### **Mejreme Berisha, pyetje për Drejtorinë e Arsimit**

Kombibusët që i bartin arsimtarët për 5-6 fshatrat e Gollakut, a ka mundësi ta dijë që a kanë të drejtë këta kombibusa me u angazhuar edhe me bartjen e qytetarëve, që mos ta ndërpresin bartjen në shtator?

**Lidhur** me pyetjen e parashtruar nga znj. Berisha, **Halim Halimi**, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, dha sqarime të nevojshme.

*Mbledhja mbaroi në orën 14:00*

**PROCESMBAJTËSI**  
**Zijadin Gashi**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Sami Hamiti, ecc. i dipl.**